



REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS / TUŽILAČKI SAVET KOSOVA / KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Në mbështetje të nenit 13 paragrafi 2, nenin 14 paragrafi 2, nënparagrafi 1, 2 dhe 3 dhe paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Duke marre parasysh specifikat e veçanta të punës në Prokuroritë e Republikës së Kosovës dhe nevojën e përmbushjes së mandatit dhe detyrave të punës;

Në pajtim me Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovë, KPK-Nr. 18/2013, të datë 29 janar 2013, për plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit, Nr. 01/2011, të datës 10 qershor 2011, dhe Vendimit të KPK-Nr. 96/2012, të datës 12 tetor 2013, Këshilli Prokurorial i Kosovë, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 05/2013

PËR CAKTIMIN E SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim menaxhimin sa me efikas të buxhetit të Prokurorisë së Shtetit, përcaktimin e procedurave dhe lartësisë së shpenzimeve të reprezentacionit për Kryeprokurorin e Shtetit, Zv. Kryeprokurorja e Prokurorisë Speciale, Prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (PZKPSH), Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, stafin menaxhues të Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (SZKPSH) dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

Neni 2 E drejta për reprezentacion

Të drejtë për reprezentacion kanë: Kryeprokurori i Shtetit, Prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (PZKPSH), Zëvendës Kryeprokurorja e Prokurorisë Speciale ("PS"), Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Kryeprokurorët e Prokurorisë Themelore, Drejtori i Përgjithshëm i PSH, Drejtori i Zyrës për Vlerësimin e Përformancës (ZVP), Menaxheret/Udhëheqësit e Zyrave në SZKPSH dhe KPK ("Menaxherët"), Shefi i Kabinetit të Kryeprokurorit të Shtetit, Zëdhënësi-ja.

Neni 3 Shpenzimet e Reprerentacionit

1. Shpenzimet e reprerentacionit përfshijnë shpenzimet që bëhen gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për pozitat e cekura më poshtë përfshijnë:
 - 1.1. Kryeprokurori i Shtetit, shpenzimet përfshijnë pijet gjatë takimeve zyrtare, drekat ose darkat zyrtare me delegacione të ndryshme dhe me KPK, si dhe dhurata të rastit në pajtim me legjislacionin në fuqi.
 - 1.2. Zëvendës Kryeprokurorja e PSRK, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, kryeprokurorët e prokurorisë themelore, Drejtori i Përgjithshëm i SZKPSH, Drejtori i Zyrës për Vlerësimin e Përformancës (ZVP), shpenzimet përfshijnë pijet gjatë takimeve zyrtare, drekat ose darkat zyrtare me delegacione të ndryshme.
 - 1.3. Prokurorët e ZKPSH, menaxheret, shefi i sabinetit të Kryeprokurorit të Shtetit, zëdhënësi-ja, zyrtari për protokoll, shpenzimet përfshijnë pijet gjatë takimeve zyrtare.
2. Shpenzimet e reprerentacionit nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara më lartë.

Neni 4 Vlera e shpenzimeve të reprerentacionit

1. Në varësi nga arsyet dhe nevojat e punës, vlera maksimale e shpenzimeve mujore të reprerentacionit është si në vijim:

a) Kryeprokurori i Shtetit	pa-kufizim
b) Prokurorët e ZKPSH	deri në 80.00 €
c) Zëvendës Kryeprokurorja e PSRK	deri në 100.00 €
d) Kryeprokurori i PA	deri në 100.00 €
e) Kryeprokurorët e PTH	deri në 100.00 €
f) Drejtori i Përgjithshëm i PSH	deri në 200.00 €
g) Drejtori i ZVP	deri në 80.00 €
h) Menaxherët e zyrave në SZKPSH dhe KPK	deri në 40.00 €
i) Shefi i Kabinetit, zëdhënësi-ja, zyrtari për protokoll	deri në 40.00 €

Neni 5
Përdorimi i shpenzimeve të reprezentacionit

Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit duhet të arsyetohen me fatura përkatëse, në pjesën e pasme të faturës të nënshkruhen nga shpenzuesi i autorizuar sipas këtij Udhëzimi dhe të ceket qëllimi i shpenzimit.

Neni 6
Shpenzimet e reprezentacionit për komisionet dhe grupet punuese

Udhëheqësve të komisioneve dhe grupeve punuese të Këshillit apo të Prokurorive, u lejohen shpenzimet e reprezentacionit pas aprovimit të kërkesës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i PSH.

Neni 7
Lartësia e shpenzimeve të reprezentacionit për komisionet dhe grupet punuese

Komisioneve dhe grupeve punuese të Këshillit apo të Prokurorive, u lejohen shpenzimet e reprezentacionit në shumën e caktuar "*ad hoc*", sipas kërkesës së udhëheqësit të komisionit apo grupit punues dhe pas aprovimit nga Drejtori i Përgjithshëm i PSH.

Neni 8
Shpenzime për reprezentacion

Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve mbyllet në ditën e fundit të muajit.

Neni 9
Planifikimi i shpenzimeve të reprezentacionit

1. Shpenzimet e reprezentacionit planifikohen në buxhetin e PSH-së dhe aprovohen për çdo viti fiskal.
2. Shërbimet e reprezentacionit duhet të shfrytëzohen me kompanitë me të cilat ekziston marrëveshja - kontrata dhe shpenzimi, fatura, paguhet përmes transferimit bankar të mjeteve në xhirollogarinë e përfituesit-ofruesit të shërbimit.

3. Në raste të veçanta kur nuk ka marrëveshje apo kontrate, sipas paragrafit 2 të këtij neni, lejohet pagesa me para të gatshme nga fondi i parave të imëta - Patty Cash, duke respektuar procedurat për blerje me vlere më të vogël se 100.00 €. Kjo vlen për shfrytëzuesit e të drejtës për shpenzime të përfaqësimit për raste kur nuk ka kompani të kontraktuar që kryen shërbime në objektin ku ofrohet shërbimi.
4. Ekzekutimi i transferimit bankar të mjeteve, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, kryhet nga Zyra për Buxhet dhe Financa e PSH.

Neni 10 **Dispozita përfundimtare**

Ky Udhëzim Administrativ, shfuqizon Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2011, të datës 10 qershor 2011 dhe Vendimin e KPK-së Nr. 96/2012, të datës 12 tetor 2012.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe nënshkrimit nga Kryetari dhe ka efekt retroaktiv nga data 1 janar 2013.

Prishtinë, më 29 janar 2013



Ismet Kabashi
[Signature]
Kryetari i Këshillit Prokurorial